



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar dhe miratuar më Datë: 30-05-2025			
Nr. Dokumenti	Nr. Akti	Nr. Akti	Vlera Vrednost
02-	035/02-	528	



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d, neni 40.2 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-49, i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr.05/L-108 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, neni 9, te ndarja dhe rindarja e fondeve të bartura, si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak, pika 1.2, bilancet e pa shpenzuara të të hyarve vetanake të komunave, dhe pika 6 dhe 7 për bartjen e buxhetit komunal, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 27.05.2025, miraton këtë:

V E N D I M

për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025

Neni 1

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për bartjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetanake të pasqepnuara të vitit 2024 në vitin 2025. Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, neni 9, te ndarja dhe rindarja e fondeve të bartura, si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak, pika 1.2, bilancet e pa shpenzuara te të hyarve vetanake të komunave, dhe pika 6 dhe 7 për bartjen e buxhetit komunal në vlerë prej **230,520.86 €** në vitin 2025, nga vlera e mjeteve prej 230,520.86 €, mjete të bartura e të pa shpenzuara nga viti 2024 janë prej **26,664.81€** (të alokuara në kategori ekonomike dhe në programe sipas planit të buxhetit të vitit 2024) dhe rritje të buxhetit nga THV janë prej **203,856.05 €**.

Neni 2

Bartja e buxhetit komunal nga të hyrat vetanake komunale shpërndahen në këto kategori ekonomike:

1. **Mallëra e shërbime në shumë prej 5,063.04 €;**
2. **Subvencione e transfere në shumë prej 4,868.26 €;**
3. **Investime kapitale në shumë prej 220,589.56 €.**

Të shpërndara në këto nën programe buxhetore:

Në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime shuma prej 5,063.04 €, në nën programet:

- **Zyra e Kryetarit (16033), shuma prej 863.04 €;**
- **Shërbimet e shëndetësisë primare (74950), shuma prej 4,200.00 €.**

Në kategorinë ekonomike, subvencione dhe transfere, shuma prej 4,868.26 €, në nën programin:

- **Zyra e Kryetarit (16033), shuma prej 4,868.26 €.**

Në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale në projekte ekzistuese, shuma prej 220,589.56 në nën programet, buxhetimi (17533), shuma prej 192,421.56€ në projektet:

- **Participim i projekteve me donator, kodi (90552), shuma prej 100,000.00 €;**
- **Blerja e autoveturave për Administratën Komunale në Viti, kodi 56349, shuma prej 9,640.00 €;**

- Rregulli i rrjethojave të shkollave “Bafti Haxhiu”, “Halil Alidema”, kodi 52817, shuma prej 4,929.77 €;
- Blerja e fotoapararit digjital professional, kodi 55192, shuma prej 1,870.00 €;
- Ndërtimi i tribunave të stadiumit në fshatin Skifteraj, kodi 56310, shuma prej 25,000.00 €;
- Ndërtimi i fushave sportive në Zhiti, Tërpezë, Trestenik, Vërban, Smirë, Beguncë, Gjylekar, Ramnishtë, kodi 53855, shuma prej 50,981.79 €;
- Shërbimet e shëndetësisë primare 74950 shuma prej 11,263 € në projektin: Renovimi i ambulantës në Viti, kodi 53893 në shumë prej 11,263.00 €;
- Arsimi i mesëm, kodi 95160, shuma prej 16,905 € në projektin: Riparimi i shkollave në Viti, Radivojc, Devaj, Pozheran, Ramjan, Gërmovë, Zhiti, Goshicë, Vërban dhe Ramnishtë kodi (53880) shuma prej 16,905.00 €.

Arsyetim

Në kërkesën për bartje të mjeteve të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025, të miratuar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, nuk ka ndryshim në strukturën e shpenzimeve të mjeteve të mbetura të pa shpenzuara nga viti 2024.

Komuna ka tejkaluar planin e të hyrave vetanake të vitit 2024 në vlerë prej 203,856.05 euro, prej 4,200.00 € janë rritur mallrat e shërbimet, ndërsa, pjesa tjetër në vlerë prej 199,656.05 €, në shpenzime kapitale.

Bartja e të hyrave në vlerë prej 5,063.04 €, në kategorinë e shpenzimeve mallra e shërbime, vlera prej 863.04 kanë mbetur pa u shpenzuar dhe vlera prej 4200 € rritje në mallra e shërbime nga të hyrat e shëndetësisë.

Bartja e të hyrave në vlerë 4,868.26 €, në subvencione e transfere bëhet se kanë mbetur pa u shpenzuar nga viti 2024, ndërsa, bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve kapitale në vlerë prej 220,589.56 €, në tetë projektet e ekzistuese bëhet nga tejkalimi i planit të shpenzimeve kapitale, për pagesën e obligimeve në këto projekte për të cilat kërkohej mjete shtesë, të pa paguara të kryhen obligimet financiare.

- Participim i projekteve me donator, kodi 90552, shuma prej 100,000.00€, për pagesën e projekteve të bashkëfinancuara me donator;
- Blerja e autoveturave për Administratën Komunale në Viti, kodi 56349, shuma prej 9,640.00 €, obligim i pa paguar;
- Rregulli i rrethojave të shkollave “Bafti Haxhiu”, “Halil Alidema”, kodi 52817, shuma prej 4,929.77 €;
- Blerja e fotoapararit digjital professional, kodi 55192, shuma prej 1,870.00 €, obligim i pa paguar;
- Ndërtimi i tribunave të stadiumit në fshatin Skifteraj, kodi 56310, shuma prej 25,000.00€, mjete shtesë nga planifikimi i buxhetit;
- Ndërtimi i fushave sportive në Zhiti, Tërpezë, Trestenik, Vërban, Smirë, Beguncë, Gjylekar, Ramnishtë, kodi 53855, shuma prej 50,781.88 € obligim i pa paguar;
- Renovimi i ambulantës në Viti, kodi 53893, në shumë prej 11,263.00 €, obligim i pa paguar;
- Riparimi i shkollave në Viti, Radivojc, Devajë, Pozheran, Ramjan, Gërmovë, Zhiti, Goshicë, Vërban dhe Ramnishtë, kodi 53880, shuma prej 16,905.00 €, obligim i pa paguar.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konformë nenit 10, pika 6 të Ligjit për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27, Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhen zyrtare në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
2. Zyrës së Kryetarit;
3. Shërbimit të Kuvendit; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Bekim Azizi

